VENDIM
Nr.26 , datë 12.04.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.25, datë 27.5.2005, neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE–s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Essegei Shqipëri Smokthina sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2006,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë Essegei Shqipëri Smokthina sh.p.k.
2. Ngarkohet Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria Essegei Shqipëri Smokthina sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjeter Dema